



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr.5028/2016

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40.2, Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr.05/L-071 për vitin 2016 neni 1 pikat 1.30, 1.31, neni 14, Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048 neni 30, Instruksioni mbi rishikimin e buxhetit nga Ministria e Financave me numër 01/973 të datës 16.05.2016, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 24.05.2016 merr:

V E N D I M
PËR RISHIKIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2016

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për rishikimin e buxhetit për vitin 2016 për kategorinë ekonomike shpenzime kapitale.

II

Rishikimi i mjeteve në total është në shumë prej 30,292.00 €, ku transferet/alokimet janë në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale në shumë prej 30,292.00 €.

III

Ri-alokimi i kategorisë ekonomike shpenzime kapitale nga fondi burimor (21) Në kuadër të programit Planifikimi urban dhe mjedisi (660) nën-programi (66480) nga projektet: Rregullimi i Kanalizimeve në lagjet e mbetura të zonave rurale të Hanit të Elezit (Rezhancë, Paldenicë, Gorancë)” kodi (41630) shuma prej 5,000 € “Hartimi i hartave zonale” kodi (41633) shuma prej 5,000 €, “Asfaltimi i rrugës Gorancë – Globoqicë” kodi (41637) shuma prej 5,000 €, “Rregullimi i prockës dhe i kanalizimit fekal në fshatin Seçishtë” kodi (44173) shuma prej 5,000 €, “Gjelbërimi i disa hapësirave publike” kodi (41640) shuma prej 1,778 €, **të ri-alokohen në projektet** “Fond për hartimin e projekteve” kodi (41642) në shumë prej 8,858 €, “Fonde për shpronësim” kodi (41628) në shumë prej 12,920 €. **Transfer i kategorisë ekonomike shpenzime kapitale nga fondi burimor (21)** Nga programi Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660) nën-programi (66480) nga projektet: “Gjelbërimi i disa hapësirave publike” kodi (41640) shuma prej 1,222 €, “Rihapja dhe rregullimi i rrugës nga fshati Dermjak deri në fshatin Neqavcë” kodi (44167) shuma prej 5,000 €, “Rihapja dhe rregullimi i rrugës nga kroi i fshatit Paldenicë - Ramuk dhe deri te rruga e veshtëve” kodi (44168) shuma prej 2,292 €, **të transferohen në programin Arsimi dhe shkenca (920) nën-programi (92175) në projektin:** “Aneksi i shkollës fillore "Ilaz Thaçi" në Han të Elezit- faza e dytë” kodi (44180) në shumë prej 8,514 €.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të kuvendit, ndërsa do të ekzekutohet pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

V

Me këtë vendim njoftohet: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Financave - Departamenti i Buxheteve Komunale dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit
Data: 24.05.2016





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.3541 /2016

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11 , 17 shkronja (r), 40.2, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 neni 2.3, Statutin e Komunës neni 74 shkronja (k). Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 24.05.2016 merr:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR “JAVËN KULTURORE” 2016

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për “Javën Kulturore” 2016 në Komunën e Hanit të Elezit.

II

Duke ju referuar nenit -I- të këtij vendimi i cila i dedikohet “Javës Kulturore” 2016, mjetet financiare do të merren nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime nga Drejtoria e Arsimit dhe Zyra e Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit. Vlera e përgjithshme e mjeteve financiare për mbështetje të “Javës Kulturore” 2016 është 4,869.25 €.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të kuvendit, ndërsa do të ekzekutohet pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

V

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Zyra e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 24.05.2016





01/Nr.4583/2016

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11 , 40, Statuti i Komunës neni 75, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 24.05.2016 merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR PROCES
TRASPARENT TË BUXHETIMIT

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për formimin e grupi punues për hartimin e planit të veprimit për procesin transparent të buxhetimit në komunën e Hanit të Elezit.

II

Grupi punues do të jetë i përbërë prej ekzekutivit të komunës dhe anëtarëve të kuvendit si më poshtë:

- Rufki Suma, Kryetar i Komunës
- Menduh Vlashi, Nënkyetar i Komunës
- Shabi Rexhallari, Drejtor për Buxhet dhe Financa
- Fari Kalisi, Drejtor i Administratës
- Miqail Vila, Drejtor i Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
- Refet Kalisi, Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencë
- Musafër Dernjani, Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Irfan Qajani, Drejtor i Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- Sevime Laçi, Drejtoreshë e Zhvillimit Ekonomik
- Hajredin Gashi, Drejtor i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- Qamush Brava, Kryesues i Kuvendit Komunal
- Basri Dernjani , Këshilltarë Komunal
- Akif Shkreta, Këshilltarë Komunal
- Bajrush Laçi, Shef i zyrës ligjore
- Bashkim Sopa, Zyrtar i transparencës
- Avni Bushi, Zyrtar i Kuvendit të Komunës

III

Detyrat e grupit punues do të synojnë të realizojnë një proces sa më transparent të buxhetimit në komunën e Hanit të Elezit, i cili do të jetë konkret, i saktë dhe në suaza të ligjeve në fuqi.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të kuvendit, ndërsa do të ekzekutohet pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

V

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Zyra e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 24.05.2016

